



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE

DIVIZIONI TEKNIK

DREJTORIA E ENERGJISË SË RINOVUESHME



Studimi:

**HARTIMI I BILANCIT ENERGJETIK BAZUAR NË
PËRPUNIMIN E INFORMACIONIT SIPAS
STANDARTEVE DHE RREGULLOREVE TË
STATISTIKËS SË ENERGJISË TË BE-SË**

**BILANCI ENERGJETIK
2023**

Tiranë 2024

Autorë

Nr.	Emri	Kualifikimi	Institucioni	Formimi
1	Artan Leskoviku	MsC	AKBN	Ing. Nxjerjes së Naftës dhe Gazit
2	Renata Aliko	MsC	AKBN	Ekonomiste
3	Teuta Thimjo	MsC	AKBN	Ing Ndërtimi
4	Evis Çano	MsC	AKBN	Ing Mjedisi dhe Energjie
5	Valentina Hita	MsC	AKBN	Ing. Elektrike
6	Denada Corbaxhi	MsC	AKBN	Eksperte

PËRMBAJTJA

1.	ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE	7
2.	BILANCI I ENERGJISË, METODOLOGJIA - EUROSTAT	9
3.	TË DHËNAT VJETORE	10
4.	TË DHËNAT MUJORE	14
5.	TË DHËNAT E ÇMIMEVE	16
6.	RAPORTIM CILËSOR PËR ENERGJINË	17
7.	POLITIKA E RISHIKIMIT	18
8.	VLERËSIMI I TË DHËNAVE	18
9.	TASK FORCAT PËR TË ARDHMEN E STATISTIKAVE TË ENERGJISË	18
10.	VLERËSIM I SHKURTËR I BURIMEVE TË RINOVUESHME TË ENERGJISË (SHARES).....	18
11.	AKBN - AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE	19
12.	BILANCI ENERGJETIK 2023	21
13.	PRODUKTET PRIMARE	22
13.1	Nafta dhe Gazi.....	22
13.2	Qymyri	25
14.	PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	26
14.1	Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike	29
14.2	Gjendja e TEC-it Vlorë.	30
14.3	Prodhimi nga impiantet fotovoltaike.....	30
14.4	Konsumi i energjisë elektrike.....	31
14.5	Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike.....	33
14.6	Import – Eksporti	34
14.7	Humbjet e energjisë elektrike.....	35
15.	BURIMET E RINOVUESHME	36
16.	DRUTË E ZJARRIT	38
17.	HIDROENERGJIA	38
18.	BIOKARBURANTET	39
19.	ENERGJIA DIELLORE	39
20.	ENERGJIA E ERËS	40
21.	TRANSFORMIMI	40
21.1	Energjia Hidrike	40
21.2	Rafineritë	41
22.	KONSUMI I ENERGJISE SIPAS SEKTOREVE	41
22.1	Sektori i industrisë.....	41
22.2	Sektori i transportit.....	42
22.3	Sektori i banesave.....	43
22.4	Sektori i shërbimeve.....	43
22.5	Sektori i bujqësisë	44
23.	ANEKS BILANCI ENERGJETIK 2023	45

LISTA E GRAFIKEVE

Grafiku 1. Prodhimi i brendshëm bruto 2018-2023.....	8
Grafiku 2. Struktura e PBB për vitin 2023 sipas sektorëve (%).....	8
Grafiku 3. Ecuria e Prodhimit, Importit dhe eksportit të produkteve të naftës (ktoe).....	23
Grafiku 4. Ecuria e përpunimit të naftës brut, (ktoe).....	23
Grafiku 5. Ecuria e Import, Eksportit të produkteve të naftës, (ktoe).....	24
Grafiku 6. Prodhimi i Gazit (ktoe).....	24
Grafiku 7. Ecuria e Prodhimit dhe Importit të Qymyrit (kton).....	26
Grafiku 8. Prodhimi neto vendas në raport me mesataren e prodhimit për periudhën 2009-2023.....	29
Grafiku 9. Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike ndër vite.....	32
Grafiku 10. Shpërndarja e numrit të klienteve në vitin 2023 sipas kategorive në %.....	33
Grafiku 11. Klientët familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite.....	34
Grafiku 12. Balanca Import – Eksport e energjisë elektrike në vite.....	35
Grafiku 13. Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes.....	36
Grafiku 14. Ecuria aktuale e kontributit të RES në Shqipëri.....	37
Grafiku 15. Ecuria e prodhimit të burimeve të rinovueshme (TJ).....	38
Grafiku 16. Ecuria e konsumit sipas sektorëve të ekonomisë (ktoe).....	41
Grafiku 17. Ecuria e konsumit të produkteve të naftës sipas sektoreve, (ktoe).....	42
Grafiku 18. Ecuria e stokut të automjeteve.....	43

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Të dhëna mbi prodhuesit e energjisë elektrike.....	27
Tabela 2. Prodhimi neto i energjisë elektrike në vendin tonë.....	28
Tabela 3. Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.).....	30
Tabela 4. Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet Fotovoltaike.....	31
Tabela 5. Shpërndarja e klienteve të OSHEE sipas rajoneve dhe kategorive gjatë vitit 2023.....	33
Tabela 6. Centrale që kanë lidhur marrëveshje deri në vitin 2023 dhe priten të energjizohen gjatë viteve 2022-2023.....	37
Tabela 7. Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet Fotovoltaikë.....	40

HYRJE

Politikat e energjisë të një vendi shërbejnë për të rritur sigurinë e furnizimit me burime energjetike dhe optimizimin e burimeve për mbulimin e nevojave me synim kryesor zhvillimin e qëndrueshëm të mbarë ekonomisë për të ardhmen. Sektori energjetik përbën bazën e zhvillimit ekonomik të çdo vendi. Ristrukturimi i sistemit energjetik kërkon marrjen e masave të rëndësishme, duke patur parasysh se ndryshimet në sektorin energjetik nuk ndodhin as spontanisht dhe as për periudha afat shkurtër. Strategjia e sektorit energjetik zhvillohet si një strategji kombëtare që ka në themel të saj interesat bazë të vendit dhe të qytetarëve/konsumatorëve të saj. Asnjë prioritet privat (për individë apo kompani të veçanta) i plotë apo i pjesshëm nuk duhet të merret parasysh përpara interesit kombëtar. Kjo çështje me rëndësi themelore konkretizohet gjatë hartimit të koncept ideve për zhvillimin e tregjeve të energjisë elektrike, të naftës dhe nënprodukteve të saj, të gazit natyror, në të cilat funksioni publik, në mënyrë të qartë dhe të prerë, duhet të ndahet nga funksioni i ndërmarrjeve private duke pasur si objektiv bazë përmirësimin e tregjeve të energjisë.

Objektivat kombëtare për vitin 2030 lidhur me rritjen e kontribuimit të burimeve primare energjetike, shtimin e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, shtimin e penetrimit të gazit natyror, zhvillimin e burimeve të ndryshme të furnizimit përmes investimeve të reja, përforcimin e bashkëpunimit dhe integritit rajonal dhe ndërlidhjen me rrjetet evropiane dhe rajonale të energjisë elektrike dhe gazit natyror, integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe gazit natyror me rajonin, përmirësimin e sigurisë së transmetimit dhe furnizimit të energjisë përmes diversifikimit të rrugëve të furnizimit dhe përmirësimin e sigurisë dhe besueshmërisë së tyre përmes investimeve kosto-efikase, do të rrisë fleksibilitetin e sistemit kombëtar të energjisë.

Sektori i energjisë është një sektor prioritar për qeverinë. Shqipëria është e pajisur me një shumëllojshmëri të gjerë burimesh energjetike duke filluar nga nafta dhe gazi, qymyri dhe lëndët djegëse të tjera fosile, hidrocentralet, biomasa pyjore natyrore dhe energji të tjera të rinovueshme.

Furnizimi me energji parësore në Shqipëri dominohet nga produktet e naftës, hidrocentralet dhe energjia elektrike e importuar neto, dru zjarri dhe një sasi e vogël qymyri dhe gazi natyror. Referuar Konsumit final të energjisë sipas burimit të energjisë për vitin 2023 rezulton se produktet e naftës janë ulur krahasuar me vitin 2022 në vlerën 5.2%, hidro dhe importi neto i energjisë elektrike janë ulur në vlerën 1.41%, dhe drute e zjarrit është reduktuar në 5.64%. Sektorët me konsumin më të lartë të energjisë në Shqipëri në vitin 2023 ishin sektori i transportit që konsumoi rreth 36.97% të energjisë finale, i ndjekur nga familjet (26.16%) dhe industria (20.67%).

Prodhimi i energjisë elektrike është përmbushur historikisht pothuajse ekskluzivisht nga hidrocentralet, me një kapacitet total të instaluar të energjisë prej 2,517 MW në fund të vitit 2023. Vendi ka shfrytëzuar afërsisht 50% të potencialit të tij hidroenergjetik dhe zgjerimi i ardhshëm i kapacitetit hidroenergjetik është i mundur kryesisht përgjatë Lumenjve Drin, Mat,

Devoll dhe Bistrica. Për shkak të investimeve të reja në hidrocentrale të vogla dhe të mesme, kapaciteti total i instaluar arriti në **2,824 MW** në vitin 2023, nga të cilat 1,448 MW janë në pronësi të shtetit (1,350 MW hidro dhe 98 MW termike), ndërsa pjesa tjetër private.

Bilanci i Energjisë ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përgatitjen e Planeve Kombëtare ekzistuese që kanë marrë në konsideratë në hartimin e dokumentave që përfshijnë Strategjinë Kombëtare për Energjinë dhe Kontributin Kombëtar të Përcaktuar (NDC). Të dhënat e bilancit të energjisë kanë kontribuar në Strategjinë Kombëtare për Energjinë për të vendosur si pikësynim që të arrijë një nivel TFEP-je prej 42% dhe një reduktim të përdorimit të energjisë me 15% krahasuar me skenarin bazë për vitin 2030.

Bilanci ka ndihmuar në përcaktimet sektoriale si p.sh., në fushën e shërbimeve, ai parashikon një rritje të ndjeshme të kërkesës për energji. Në fushën e transportit, e konsideron opsionin e elektrifikimit dhe zvogëlimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit.

Për të përmirësuar sektorin e prodhimit gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka punuar për të ndryshuar politikën e efikasitetit të energjisë duke mbështetur përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, duke e bërë atë pjesë të strategjisë energjetike të vendit. Për shkak të rënies së kostove të teknologjisë dhe potencialit të konsiderueshëm të energjisë së rinovueshme që ka vendi, PV-të e erës dhe diellore mund të përdoren me kosto efektive për të zbutur ndikimin në çmimin e energjisë elektrike tek konsumatorit fundor. Deri në fund të vitit 2023, ishin instaluar 207 MW shtesë PV diellore.

Viti 2023 ishte një tjetër vit sfidues për ekonominë shqiptare. Rritja e shpejtë e inflacionit, e diktuar në masën më të madhe nga rritja e çmimeve në tregjet botërore pas konfliktit ushtarak në Ukrainë, ndikoi çdo aspekt të aktivitetit ekonomik dhe financiar në vend. Ajo u pasqyrua në rritje të pasigurisë, në rritje të kostove të prodhimit për bizneset, në rritje të kostove të jetesës për familjet, dhe në shtrëngim të kushteve të financimit, si për sektorin publik ashtu dhe për atë privat.

Përkundrejt këtyre zhvillimeve, ekonomia shqiptare ka pasur një ecuri relativisht solide gjatë vitit. Rritja ekonomike në tre tremujorët e parë të vitit rezultoi 4.2%, ndërsa tendencat përmirësuese në tregun e punës u shprehën në rritjen e punësimit dhe të pagave, dhe në uljen e shkallës së papunësisë në minimumin e saj historik.

Norma mesatare e inflacionit në vitin 2023 shënoi nivelin 6.7%, nga 2.0% një vit më parë. Rritja e inflacionit ka pasqyruar, në masën më të madhe, ndikimin e goditjeve të ofertës së huaj. Megjithatë, përcjellja e tyre në ekonominë shqiptare është favorizuar nga kërkesa e qëndrueshme për mallra e shërbime, nga reduktimi i kapaciteteve të pashfrytëzuara në tregun e punës dhe nga rritja e pritjeve për inflacionin.

Pavarësisht rritjes së çmimeve, ekonomia shqiptare shfaqti një rezistencë të mirë ndaj goditjes. Konsumi, investimet dhe eksportet shqiptare shënuan rritje, duke pasqyruar nga njëra anë fleksibilitetin dhe shëndetin e bilanceve financiare të sektorit privat, dhe nga ana tjetër një miks

të kujdesshëm politikash stimuluese monetare e fiskale. Sipas të dhënave të INSTAT-it, aktiviteti ekonomik u rrit me mesatarisht 3.44% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2023 dhe pati një shpërndarje të mirë sektoriale. Megjithatë, ritmet e rritjes shfaqën luhatje gjatë tremujorëve dhe patën një trend ngadalësues gjatë vitit, duke pasqyruar përkatësisht rritjen e shpejtë të pasigurive në tremujorin e dytë dhe efektin e bazës krahasuese.


1. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Produkti i Brendshëm Bruto

Ekonomia është ngadalësuar në vitin 2023 tregojnë të dhënat më të fundit të INSTAT. Me vlerësimin e tremujorit të fundit, INSTAT jep një vlerësim paraprak të PBB-së për vitin 2023, i cili mbështetur në vlerësimet tremujore, shënoi një rritje prej 3.44%, krahasuar me vitin 2022 kur rritej me 4.84%. Të dhënat tregojnë se që nga viti 2021, ku PBB-ja paraqitej me rritje në 8.91%, në vitet pasuese ky tregues ka ardhur duke rënë. Nga ana tjetër, konsumi i popullatës, i cili përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, u rrit gjithashtu me vetëm 1.55% në tremujorin e fundit, nga 2% që rritej në tremujorin e tretë të vitit.

Ndërkohë, Produkti i Brendshëm Bruto në tremujorin e katërt të vitit 2023 vlerësohet me rritje prej 3.80%, kundrejt tremujorit të katërt të vitit 2022. Ndërtimi është zëri që ka regjistruar kontributin më të lartë me 1.28 pikë, ndjekur nga Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia me 1.01 pikë përqindje, Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative me 0.66 pikë përqindje, Aktivitete të pasurive të paluajtshme me 0.58 pikë përqindje, Arte, argëtim dhe çlodhje; aktivitete të tjera shërbimi me 0.46 pikë përqindje, Informacioni dhe Komunikacioni me 0.28 pikë përqindje, Aktivitete Financiare dhe të Sigurimit me 0.15 pikë përqindje, Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor me 0.07 pikë përqindje. Negativisht kontriboi grup: Bujqësi, Pyje dhe Peshkim me 0.72 pikë përqindje, Industri, Energji dhe Uji me 0.23 pikë përqindje. Taksat Neto mbi produktet kontribuan pozitivisht me 0.27 pikë përqindje.


Aktiviteti i Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit shënoi rënie prej 3.07%. Aktiviteti i Industrisë, Energjisë dhe Ujit pati një rënie me 2.03%. Aktiviteti i Ndërtimit, nga ana tjetër, pati një rritje me 10.80%. Grupi i aktiviteteve Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor pati një rritje prej 0.38%. Grupi i aktiviteteve Informacioni dhe Komunikacioni u shfaq me rritje prej 8.81%. Aktiviteti Financiar dhe i Sigurimit ka shënuar një rritje prej 7.50% dhe aktiviteti i Pasurive të Paluajtshme ka shënuar një rritje prej 10.33%.



Grafiku 1. Prodhimi i brendshëm bruto 2018-2023

Aktiviteti ekonomik në vend ka pasur një trajektore pozitive gjatë vitit 2023, duke u shfaqur rezistent ndaj goditjeve të viteve të fundit. Vëllimi i aktivitetit ekonomik ka ardhur në rritje, i ushqyer nga zgjerimi i kërkesës së brendshme dhe të huaj për mallra e shërbime. Kjo dinamikë ka pasqyruar përmirësimin e besimit në ekonomi, bilancet e shëndosha financiare të sektorit privat, ambientin ende stimulues financiar, si dhe rritjen e shpejtë të kërkesës për shërbime të turizmit.

Nga kontributi i sektorëve shikohet se pjesa më e madhe e tyre kanë të nevojshme të rishikojnë performancën nëpërmjet rishikimit të modelit të biznesit dhe produktivitetit. Mbi këtë bazë duket se dhe tremujori i fundit i vitit 2023 nuk do të prezantojë ndryshime të tendencave rënëse të sektorëve në vlerën e zhvillimit të ekonomisë. Nga kjo situatë stanjative apo dhe me tendencë zhvillimi të ngadaltë dhe në disasektorë si prodhimi edhe rënëse, duket se e ka fillimin pas pandemisë, por në fakt fillon një rënie e tyre që nga viti 2019.



Grafiku 2. Struktura e PBB për vitin 2023 sipas sektorëve (%)

Kur PBB-ja po ndikohet nga fare pak sektorë të ekonomisë dhe specifikisht nga sektorët e ndërtimit bashkë me pasuritë e paluajtshme, si dhe nga shpenzimet e administratës, kjo kërkon vëmendje për një analizë të veçantë për secilin sektor për të parë problemet e modelit, tregut dhe nevojës apo jo për ndërhyrje. Edhe pse GDP mund të jetë në rritje, por me ritmet që po ecën Shqipëria në vitet e dekadës së fundit kjo është një rritje e pamjaftueshme për të mundësuar vende pune për brezin e ri të tregut të punës dhe sipërmarrësve.

Mungesa e industrisë së rëndë apo industrisë së lidhur me të nuk mund të konsiderohet domosdoshmërisht një fenomen negativ i ekonomisë sonë. Arsyet që ekonomia jonë nuk operon më mbi bazat e sektorëve të industrisë së rëndë dhe industrive automotive e minerare tashmë është pasojë e rritjes së shpejtë të sektorëve të tregtisë dhe shërbimeve, si dhe disa degëve të manifakturës, kryesisht për eksport.

2. BILANCI I ENERGJISË, METODOLOGJIA - EUROSTAT

Statistikat vjetore dhe mujore të energjisë

Legjislacioni kryesor për mbledhjen e të dhënave për sasi të energjisë është rregullorja e BE-së 1099/2008 për statistikën e energjisë.

Çmimet e energjisë elektrike dhe gazit natyror

Baza ligjore për mbledhjen dhe raportimin e statistikave të çmimeve të gazit natyror dhe energjisë elektrike për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë është rregullorja e BE-së 2016/1952.

Rezervat e emergjencës së naftës

Baza ligjore për mbledhjen e të dhënave të rezervave emergjente të naftës është direktiva e Këshillit 2009/119/EC e cila detyron Shtetet Anëtare të BE-së të mbajnë rezerva minimale të naftës së papërpunuar dhe/ose produkteve të naftës. Kjo është ndryshuar nga direktiva e BE-së 2018/1581 për metodat e llogaritjes së detyrimeve të stokut.

Energjia nga burimet e rinovueshme

Përdorimi i energjisë nga burimet e rinovueshme zvogëlon varësinë nga karburantet e importuara nga vendet jo anëtare të BE-së dhe emetimet nga burimet e karburanteve fosile.

Kuadri ligjor aktual është direktiva e BE-së 2018/2001 për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme (e ndryshuar disa herë). Ai vendos objektiva dhe rregulla të reja llogaritjeje. Deri në vitin 2030, 42.5% e energjisë së prodhuar në BE duhet të vijë nga burimet e rinovueshme.

Përpara këtij kuadri ligjor, objektivat kombëtare për energjinë nga burimet e rinovueshme deri në vitin 2020 janë përcaktuar në direktivën e BE-së 2009/28 për promovimin e përdorimit të

energjisë nga burimet e rinovueshme. Kjo direktivë vendosi gjithashtu kritere kontabël për pjesën e energjisë nga burimet e rinovueshme.

Efiçienca e energjisë

Korniza e përbashkët e masave për promovimin e efiçencës së energjisë është vendosur në direktivën e BE-së 2012/27 për efiçencën e energjisë.

Kjo direktivë trajton arritjen e objektivit prej 20% për efiçencën e energjisë në vitin 2020. Përcaktimi sasior i objektivit të ish-Efiçencës së energjisë të BE-28 ishte: “konsumi i energjisë i Bashkimit për vitin 2020 prej jo më shumë se 1,483 milion ton ekuivalent naftë (Mtoe) primar energji ose jo më shumë se 1,086 Mtoe energji përfundimtare”.

3. TË DHËNAT VJETORE

Baza ligjore

Vendet që raportojnë të dhëna për energjinë në Eurostat duhet t'i transmetojnë këto të dhëna siç përshkruhet në aneksin B të rregullores së BE-së 1099/2008 mbi statistikat e energjisë.

Formati i duhur i transmetimit të të dhënave është versioni më i fundit i pyetësorëve vjetorë të energjisë në formatin Excel.

Këto janë versionet më të fundit të pyetësorëve vjetorë të energjisë që duhet të përdoren për transmetimin zyrtar të të dhënave, së bashku me udhëzimet e tyre raportuese shoqëruese:

Biomasa, pyetësor vjetor

- Udhëzimet e raportimit

Përkufizimet dhe konventat e raportimit të përdorura në këtë pyetësor janë në përputhje me ato të përdorura në pyetësorin vjetor të burimeve të rinovueshme dhe mbetjeve. Prandaj, konsistenca midis të dhënave të raportuara në të dy pyetësorët respektohet sa më shumë që është e mundur. Për më tepër, përkufizimet dhe qëllimi i përdorur në këtë pyetësor janë konsultuar dhe harmonizuar me organizatat ndërkombëtare (FAO, OKB), drejtoritë e tjera të Komisionit Evropian (DG ENER, ENV, CLIMA dhe JRC), si dhe me fusha të tjera statistikore (bujqësi, pylltari) në Eurostat. Njësitë raportuese në këtë pyetësor janë, me një përjashtim, të shprehura në m³ për të përmbushur detyrimin e Rregullores së Qeverisjes për të raportuar në këto njësi. Prandaj, shablloni ofron mundësinë që vendet raportojnë vlerat mesatare kalorifike dhe transformojnë vëllimet në njësi energjie (TJ), për të lehtësuar krahasimin me pyetësorin vjetor të Burimeve të Rinovueshme dhe mbetjeve. Aty ku është e mundur, raportohet vlerat mesatare kalorifike.

Qymyri, pyetësor vjetor

- Udhëzimet e raportimit

Të dhënat raportohen për vitet kalendarike. Nëse duhet të përdoren të dhënat e vitit fiskal, kjo deklarohet qartë dhe specifikisht për periudhën e mbuluar. Raportimi duhet të jetë i qëndrueshëm në të gjitha seritë kohore për çdo vit të caktuar, duke shmangur çdo mospërputhje midis flukseve, produkteve ose teknologjive, raportuar në Terajoules (TJ) në bazë të vlerave kalorifike bruto (GCV). Të dhënat për vlerat kalorifike raportohen si për neto ashtu edhe për bruto, dhe duhet të jenë në kJ/kg (MJ/t). Një bazë "si është" përfshin të gjithë hirin dhe lagështinë, dhe produktet me hi ose lagështi të lartë mund të kenë vlera kalorifike në bazë të konsiderueshme më të ulëta se kufijtë e klasifikimit të produktit në bazë të lagësht, por pa hi, ose pa lëndë minerale të thatë.

Prodhimi i kombinuar i nxehtësisë dhe energjisë (CHP), pyetësor vjetor

- Udhëzimet e raportimit

Qëllimi i këtyre udhëzimeve të raportimit është të ndihmojë statisticienët në Shtetet Anëtare të BE-së dhe në vende të tjera që të plotësojnë saktë modelin e raportimit të CHP-së. Është shkruar në një mënyrë që t'i bëjë edhe ekspertët jo- CHP të kuptojnë idetë dhe konceptet bazë pas mbledhjes së të dhënave. Prandaj, disa aspekte përshkruhen në mënyrë të thjeshtuar dhe ndoshta nga pikëpamja teknike nuk janë gjithmonë 100% të sakta. Kjo është bërë për t'i mbajtur këto udhëzime të menaxhueshme. Qëllimi i statistikave të CHP-së është mbledhja e të dhënave në mënyrë të harmonizuar për këtë teknologji specifike për politikëbërësit, duke i lejuar ata të kuptojnë lehtësisht se si zhvillohet kjo fushë. Të dhënat e mbledhura nuk mblidhen për të ndërtuar skema të cilësisë së CHP-së dhe gjithashtu nuk do të përdoren për të parë se cili operator mund të kërkojë subvencione për produktet e tij CHP. Metoda për mbledhjen e statistikave të CHP-së duhet të jetë në gjendje të përballojë të gjitha tiparet e ndryshueshme teknike dhe operacionale të prodhimit të CHP-së në mënyrë që të ndajë gjenerimin e CHP-së nga prodhimi total në një mënyrë të qëndrueshme dhe të saktë.

Pyetësi vjetor i ngrohjes dhe ftohjes qendrore (DH-DC)

- Udhëzimet e raportimit

Bazuar në përkufizimin ekzistues në nenin 2(19) të Direktivës 2010/31/EU për Performancën Energjetike të Ndërtesave (EPBD), 2010 "ngrohja qendrore" ose "ftohja qendrore" nënkupton shpërndarjen e energjisë termike në formën e avullit të nxehtë, ujë ose lëngje të ftohta, nga një burim qendror prodhimi përmes një rrjeti në ndërtesa, për përdorimin e hapësirës ose të procesit të ngrohjes ose ftohjes. Ky grumbullim i të dhënave sipas nenit 24(6) EED zbaton përkufizimin e DHC të nenit 2(19) EPBD. Të dhënat e mëposhtme – të cilat plotësojnë kriteret e listuara më poshtë – i raportohen Eurostatit.

Pyetësi vjetor i Energjisë elektrike dhe ngrohjes,

- Udhëzimet e raportimit

Të dhënat duhet të raportohen për vitet kalendarike. Nëse duhet të përdoren të dhënat e vitit fiskal, kjo deklarohet qartë dhe specifikisht për periudhën e mbuluar. Raportimi duhet të jetë i

qëndrueshëm në të gjitha seritë kohore për çdo vit të caktuar, duke shmangur çdo mospërputhje midis flukseve, produkteve ose teknologjive. Përkufizimet dhe konventat e raportimit të përdorura në këtë pyetësor janë të njëjta me ato të përdorura në pyetësorët e tjerë vjetorë (Qymyri (Lëndët djegëse të ngurta fosile dhe gazet e prodhuara), Nafta, Gazi Natyror dhe Burimet e Rinovueshme). Duhet siguruar që të dhënat për lëndët e përdorura për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes të raportuara në pyetësorët e tjerë vjetorë të jenë në përputhje me ato të raportuara për të njëjtat kategori në pyetësorin e Energjisë Elektrike dhe ngrohjes.

Pyetësori vjetor i Konsumit të Energjisë në Banesa,

- Udhëzimet e raportimit

Qëllimi kryesor i këtij pyetësori është të raportojë sasinë e lëndës djegëse dhe energjinë elektrike të konsumuar nga sektori i ekonomive familjare në mbështetje të aktiviteteve të tij parësore. Një familje nënkupton një person që jeton vetëm ose një grup njerëzish që jetojnë së bashku në të njëjtën banesë private dhe ndajnë shpenzimet duke përfshirë sigurimin e përbashkët të gjërave thelbësore të jetesës. Sektori i ekonomive familjare, i njohur gjithashtu si sektori i banesave (ose shtëpiake), është për rrjedhojë një grup kolektiv i të gjitha familjeve në një vend.

Pyetësori vjetor i Konsumit të Energjisë në Industri.

- Udhëzimet e raportimit

Qëllimi kryesor i këtij pyetësori është të raportojë sasinë e lendeve djegëse të konsumuara nga sektori industrial në mbështetje të aktiviteteve të tij parësore. Vetëm për ngrohjen ose njësitë CHP, duhet të raportohen vetëm sasinë e lendeve djegëse të konsumuara për prodhimin e nxehtësisë së përdorur nga vetë njësia ekonomike (nxehtësia e konsumuar automatikisht). Sasinë e lëndëve djegëse të konsumuara për prodhimin e nxehtësisë së shitur, dhe për prodhimin e energjisë elektrike, raportohen në sektorin përkatës të transformimit.

Pyetësori vjetor i Konsumit të energjisë në shërbime.

- Udhëzimet e raportimit

Qëllimi kryesor i këtij pyetësori është të raportojë sasinë e lëndëve djegëse të konsumuara nga sektori i shërbimeve në mbështetje të aktiviteteve të tij parësore. Vetëm për ngrohjen ose njësitë CHP, duhet të raportohen vetëm sasinë e lëndëve djegëse të konsumuara për prodhimin e nxehtësisë së përdorur nga vetë njësia ekonomike (nxehtësia e konsumuar automatikisht). Sasinë e lendeve djegëse të konsumuara për prodhimin e nxehtësisë së shitur, dhe për prodhimin e energjisë elektrike, raportohen në sektorin përkatës të transformimit.

Pyetësori vjetor i Konsumit të Energjisë në Transport.

- Udhëzimet e raportimit

Qëllimi kryesor i këtij pyetësori është të lehtësojë raportimin e sasive të lëndëve djegëse të konsumuara nga sektori i transportit, në përputhje me Rregulloren (KE) 1099/2008. Fokusi është

në ofrimin e një pasqyre gjithëpërfshirëse të konsumit të energjisë lidhur me aktivitete të ndryshme transporti. Energjia e përdorur në të gjitha aktivitetet e transportit duhet të raportohet pavarësisht nga kategoria NACE në të cilën ndodh aktiviteti. Lëndët djegëse të përdorura për ngrohje dhe ndriçim në stacionet hekurudhore, stacionet e autobusëve, kalatat e transportit dhe aeroportet raportohen në sektorin e Shërbimeve dhe jo në sektorin e Transportit.

Pyetësi vjetor i Hidrogjenit.

- Udhëzimet e raportimit

Të dhënat duhet të raportohen për vitet kalendarike. Nëse duhet të përdoren të dhënat e vitit fiskal, kjo deklarohet qartë dhe specifikisht për periudhën e mbuluar. Raportimi duhet të jetë i qëndrueshëm në të gjitha seritë e ndryshme kohore të lëndës të çdo viti të caktuar, duke shmangur çdo mospërputhje midis flukseve, produkteve ose teknologjive. Përkufizimet dhe konventat e raportimit të përdorura në këtë pyetësor janë të njëjta me ato të përdorura në pyetësorët e tjerë vjetorë (Nafta e papërpunuar dhe produktet e naftës, Lëndët djegëse fosile të ngurta dhe gazet e prodhuara nga qymyri, gazi natyror, burimet e rinovueshme dhe mbetjet, dhe energjia elektrike dhe nxehtësia). Gjatë procesit të raportimit ka shumë aspekte që kërkojnë vëmendje dhe konsideratë. Duhet siguar që të dhënat për hidrogjenin e raportuar në këtë shabllon raportimi të jenë në përputhje me flukset përkatëse të raportuara në pyetësorët e tjerë vjetorë.

Pyetësi vjetor i Gazit natyror.

- Udhëzimet e raportimit

Të dhënat duhet të raportohen për vitet kalendarike. Nëse duhet të përdoren të dhënat e vitit fiskal, kjo deklarohet qartë dhe specifikisht për periudhën e mbuluar. Për konsistencë ndërmjet administratave dhe për t'u përshtatur me softuerin kompjuterik, të dhënat e raportuara në këtë pyetësor duhet të jenë numerike me saktësi deri në 3 shifra dhjetore në njësinë e treguar për secilën tabelë. Raportimi kërkon të jetë i qëndrueshëm në të gjitha seritë kohore për çdo vit të caktuar, duke shmangur çdo mospërputhje midis flukseve, produkteve ose teknologjive. Përkufizimet dhe konventat e raportimit të përdorura në këtë pyetësor janë të njëjta me ato të përdorura në pyetësorët e tjerë vjetorë (Qymyri (Lëndët djegëse të ngurta fosile dhe gazrat e prodhuar), Nafta, Energjitë e Rinovueshme dhe mbetjet dhe Energjia Elektrike dhe nxehtësia). Duhet të sigurohemi që të dhënat për lëndët djegëse të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes të raportuara në këtë pyetësor të jenë në përputhje me ato të raportuara për të njëjtat kategori në pyetësorin e Energjisë Elektrike dhe ngrohjes.

Pyetësi vjetor i Energjisë Bërthamore.

- Udhëzimet e raportimit

Të dhënat për energjinë bërthamore të raportuara nga pyetësorët kanë të bëjnë vetëm me motorët civilë që veprojnë në reaktorë. Qëllimet për të cilat janë prodhuar janë të prodhojnë energji

elektrike ose aplikime të tjera të ndryshme. Ai veçon reaktorët e veprimit për qëllime ushtarake, kërkimore, demonstruese dhe lloje të tjera të ngjashme të reaktorëve eksperimentalë.

Pyetësi vjetor i Naftës.

- Udhëzimet e raportimit

Të dhënat duhet të raportohen për vitet kalendarike. Nëse duhet të përdoren të dhënat e vitit fiskal, kjo deklarohet qartë dhe specifikisht për periudhën e mbuluar. Raportimi duhet të jetë i qëndrueshëm në të gjitha seritë e kohës për çdo vit, duke eliminuar çdo mospërputhje midis flukseve, produkteve ose teknologjive. Përkufizimet dhe konventat e raportimit të lidhura në këto pyetësore janë të lidhura me pyetësorët e tjerë vjetorë. Duhet siguruar që të dhënat për naftën janë për prodhimin e energjisë elektrike dhe nxehtësi. Në mënyrë të ngjashme, sigurohen të dhënat për biokarburantet e lëngshme për përmbajtjen e lëndëve djegëse të raportuara në këtë pyetësor dhe që nuk janë të lidhura me ato të raportuara në pyetësorin për burimet e rinovueshme.

Pyetësi vjetor i Energjive të Rinovueshme dhe Mbetjeve.

- Udhëzimet e raportimit

Të dhënat duhet të raportohen për vitet kalendarike. Për konsistencë ndërmjet administratave dhe për t'u përshtatur me softwerin kompjuterik, të dhënat e raportuara në këtë pyetësor duhet të llogaritet me saktësi deri në 3 shifra dhjetore në njësinë e treguar në tabela. Raportimi kërkon të jetë i qëndrueshëm në të gjitha seritë kohore për çdo vit të caktuar, duke shmangur çdo mospërputhje midis flukseve ose produkteve ose teknologjive.

Përkufizimet dhe konventat e raportimit të lidhura me këto pyetësore janë të lidhura me pyetësorët e tjere më të hershëm (Qymyri, Lëndët djegëse të ngurta fosile dhe gazrat e prodhuar, Nafta, Gazi natyror si dhe Energjia Elektrike dhe Nxehtësia). Të dhënat për karburantet e përdorura për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes të raportuara në këtë pyetësor janë në përputhje me ato të raportuara për të njëjtat kategori në pyetësorin e Energjisë Elektrike dhe ngrohjes. Në mënyrë të ngjashme, duhet që të dhënat për biokarburantet e lëngjeve për përzierjen me karburantet e transportit të raportuara në këto pyetësore të jenë të lidhur me ato të raportuara për flukset e lidhura me pyetësorin e mjedisit.

4. TË DHËNAT MUJORE

Baza ligjore

Vendet raportojnë për energjinë në Eurostat duhet t'i transmetojnë këto të dhëna siç është raportuar në anekset C dhe të rregulloreve të BE-së 1099/2008 mbi statistikat e suksesshme.

Baza ligjore për mbledhjen e të dhënave për reduktimin e konsumit të gazit është rregullorja e BE-së 2022/1369 për masat e koordinuara për uljen e kërkesës për gaz. Vendet e BE-së duhet të

reduktojnë konsumin e gazit nga 1 gushti 2022 deri më 31 mars 2023 me të paktën 15%. Kjo matet në krahasim me konsumin mesatar të gazit të tyre ndërmjet 1 gushtit dhe 31 marsit për vitet 2017-2021. Vendet e BE-së raportojnë uljen e kërkesës së tyre çdo dy muaj.

Formati i duhur i transmetimit të të dhënave është versioni më i fundit i pyetësorëve mujor të energjisë në formatin Excel.

Këto versionet më të fundit të pyetësorëve mujorë të cilët duhet të kenë për informacionin zyrtar të të dhënave, së bashku me udhëzimet e tyre të raportimit:

Pyetësi mujor i qymyrit

- Udhëzimet e raportimit

Formati i ri i pyetësit fillon të prezantohet në muajin referues Janar 2023; Eurostat rekomandon fuqimisht përdorimin e këtij formati të ri që nga ai muaj. Pyetësi dërgohet në Eurostat brenda 2 muajve pas muajit të referencës. Përkufizimet janë marrë nga RREGULLORE (KE) NR 1099/2008 (ndryshuar në 2017).

Importet dhe furnizimi i naftës bruto, pyetësor mujor

- Udhëzimet e raportimit

Pyetësi i plotësuar i transmetohet Eurostatit nëpërmjet Pikës së vetme hyrëse (SEP) duke ndjekur procedurat zbatuese të EDAMIS (Sistemi i Informacionit të Administrimit dhe Menaxhimit të Dosjeve Elektronike), duke zgjedhur mbledhjen elektronike të të dhënave ENERGY_COIR_M dhe duke treguar vitin dhe muajin e dorëzimit.

Energjia elektrike, pyetësor mujor

- Udhëzimet e raportimit

Formati i ri i pyetësit prezantohet në muajin referues Prill 2023; Eurostat rekomandon fuqimisht përdorimin e këtij formati të ri që nga ai muaj. Pyetësi dërgohet në Eurostat brenda 2 muajve pas muajit të referencës. Pyetësi përdor një shabllon të ri të prezantuar në vitin 2023. Kur hapet ky pyetësor, janë të dukshme një faqe e kopertinës (Menu) dhe një faqe udhëzimesh. Udhëzimet teknike për mënyrën e përdorimit të pyetësit të ri janë të përfshira në fletën e udhëzimeve të pyetësit.

Pyetësi mujor i naftës (MOSOIL)

Nafta bruto është një vaj mineral me origjinë natyrore që përbëhet nga një përzierje e hidrokarbureve dhe papastërtive të lidhura, si squfuri. Ekziston në fazën e lëngshme nën temperaturën dhe presionin normal të sipërfaqes dhe karakteristikat e tij fizike (densiteti, viskoziteti, etj.) janë shumë të ndryshueshme. Pyetësi dërgohet në Eurostat brenda 2 muajve pas muajit të referencës. Vazhdon të përdoret Pyetësi ekzistues.

Pyetësi mujor i gazit natyror (MOSGAS)

- Udhëzimet e raportimit

NGL janë hidrokarbure të lëngshme ose të lëngshme të marra nga gazi natyror në objektet e ndarjes ose impiantet e përpunimit të gazit. Lëngjet e gazit natyror përfshijnë etanin, propanin, butanin (normal dhe izo-), (iso) pentanin dhe pentanet plus (ndonjëherë të referuara si benzinë natyrale ose kondensatë bimore). Pyetësi dërgohet në Eurostat brenda 2 muajve pas muajit të referencës. Vazhdon të përdoret Pyetësi ekzistues dhe pritet të krijohet pyetësi i 2024.

5. TË DHËNAT E ÇMIMEVE

Baza ligjore

Kërkesat ligjore për raportimin e statistikave të çmimeve të gazit natyror dhe energjisë elektrike për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë janë përcaktuar në rregulloren e BE-së 2016/1952. Format i duhur i transmetimit të të dhënave është pyetësi në formatin Excel.

Pyetësori dhe udhëzime raportuese

Këto janë versionet më të fundit të pyetësorëve që përdoren për transmetimin zyrtar të të dhënave, së bashku me udhëzimet e tyre të raportimit:

- Çmimet e energjisë elektrike në familje, pyetësor dy herë në vit
- Çmimet e energjisë elektrike jo-familjare, pyetësor dy herë në vit
- Çmimet e gazit në familje, pyetësor dy herë në vit
- Çmimet e gazit jo-familjare, pyetësor dy herë në vit
- Udhëzimet e raportimit

Rregullorja (BE) 2016/1952 mbi çmimet e gazit natyror dhe të energjisë elektrike, “çmimet përfshijnë të gjitha tarifat e pagueshme: tarifat e rrjetit plus energjinë e konsumuar, minus çdo zbritje apo prime, plus çdo tarifë tjetër (p.sh. qiraja e njehsorëve, tarifat e përhershme). Tarifat e lidhjes fillestare përjashtohen”. Pyetësorët e çmimeve kërkojnë një ndarje të detajuar në komponentë të ndryshëm të çmimeve, duke përfshirë nënkomponentët e taksave. Megjithatë, pyetësorët nuk përfshijnë një komponent për subvencione dhe shtesa. Duke qenë se të dhënat për subvencionet dhe shtesat janë të nevojshme për të identifikuar çmimin përfundimtar të paguar nga konsumatorët, janë dhanë udhëzime specifike për periudhën referuese 2021S2 se si të raportojnë këto të dhëna. Megjithatë, raportimi i propozuar fillimisht i lejimeve, i cili ndryshonte në varësi të faktit nëse TVSH ishte ngarkuar në çmim me ose pa lejime, uli krahasueshmërinë e të dhënave ndërmjet vendeve. Për këtë arsye, ky shënim metodologjik prezanton një qasje uniforme për raportimin e subvencioneve dhe shtesave që nga viti 2022S1, sipas së cilës të gjitha subvencionet dhe lejimet që u jepen konsumatorëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror duhet

të raportohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht se si ndërveprojnë me TVSH-në. Metodologjia është diskutuar në nivel të Task Forcës e cila është mbështetur nga ekspertët e vendeve në takimin e prillit 2022 të Grupit të Punës të Statistikave të Energjisë (ESWG).

6. RAPORTIM CILËSOR PËR ENERGJINË

Rregullorja e BE-së 1099/2008 për statistikave të energjisë kërkon ofrimin e raporteve të cilësisë në përputhje me Nenin 6 Paragrafi 4: “Çdo pesë vjet, Shtetet Anëtare i ofrojnë Komisionit (Eurostat) një raport mbi cilësinë e të dhënave të transmetuara si dhe mbi metodologjinë e ndryshimet që janë bërë.”

Rezultatet e raundit të tretë të raportimit cilësor

Në vitin 2023, vendet dhanë raportet e tyre të cilësisë për raundin e tretë të raportimit të cilësisë për sasi të energjisë. Informacioni është i disponueshëm në dokumentin e meta të dhënave mbi statistikave të energjisë. Rezultatet e këtij cikli raportimi janë paraqitur në raportin e cilësisë së statistikave të energjisë të BE-së, 2023.

Ky dokument mbulon të gjitha njëzet e tetë shtetet anëtare të BE-së në vitin 2016 (periudha në të cilën është mbledhur informacioni për përpunimin e këtij raporti). Viti referencë që është përzgjedhur për informacionin e transmetuar nga vendet është 2014. Me fjalë të tjera, informacioni i transmetuar në kuadër të raporteve kombëtare të cilësisë i referohet vitit 2014. Megjithatë, kur disponohet informacion më i përditësuar për disa seksione të këtij dokumenti, përfshihet edhe në këtë raport.

Teksti kryesor ligjor në fushën e statistikave të energjisë (dhe veçanërisht në fushën e raportimit të cilësisë për statistikave të energjisë) është Rregullorja (KE) Nr. 1099/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2008 mbi statistikave të energjisë (dhe ndryshimet e mëvonshme), i cili parashikon vlerësimin e cilësisë dhe raportet e cilësisë sipas nenit 6.

Raundet e mëparshme

Ushtrimi i parë i raportimit të cilësisë u krye ndërmjet viteve 2010 dhe 2013. Objektivi i tij ishte të merrte informacion të përgjithshëm dhe një pasqyrë fillestare se si mblidhen dhe përpilohen statistikave nga shtetet anëtare të BE-së. Ushtrimi i dytë i raportimit të cilësisë u krye në 2015-2016.

Raportet e cilësisë – Çmimet

Një përmbledhje e rezultatit të ushtrimit të parë mbi raportimin e cilësisë për gazin natyror dhe energjinë elektrike në BE është në dispozicion në raportin e cilësisë për semestrat 2022-2023.

Ky raport përmban informacion të përmbledhur për ushtrimin e dytë mbi raportimin cilësor në fushën e çmimeve të gazit natyror dhe energjisë elektrike në Bashkimin Evropian. Objektivi i tij

kryesor është të analizojë aspektet kryesore të cilësisë së të dhënave të çmimeve të gazit natyror dhe energjisë elektrike dhe të zbulojë fushat për ta përmirësuar atë në të ardhmen. Objekti i tij është duke analizuar performancën cilësore për vitet referuese 2021, 2022 dhe 2023.

7. POLITIKA E RISHIKIMIT

Politika e rishikimit për statistikat e energjisë paraqet një hap të rëndësishëm drejt harmonizimit të praktikave të rishikimit brenda Sistemit Statistikor Evropian (ESS). Një politikë e përbashkët rishikimi për statistikat e energjisë do të përmirësojë cilësinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave kombëtare si dhe do të përmirësojë cilësinë e përgjithshme të agregatëve të Bashkimit Evropian. Politika e rishikimit dhe formulari i njoftimit paraparak u miratuan gjatë takimit të grupit të punës së Statistikave të Energjisë në tetor 2015.

8. VLERËSIMI I TË DHËNAVE

Manuali i vlefshmërisë është një kontribut thelbësor për cilësinë e lartë të statistikave të energjisë. Duke qenë se vërtetimi i statistikave të energjisë është një ushtrim shumë kompleks, nuk është e mundur të përshkruhen të gjitha rregullat në terma të formulave të sakta matematikore. Dokumenti liston vetëm rregullat e vlefshmërisë për të cilat nuk ka mosmarrëveshje metodologjike ose konceptuale.

9. TASK FORCAT PËR TË ARDHMEN E STATISTIKAVE TË ENERGJISË

Statisticienët po punojnë vazhdimisht për të përmbushur kërkesën në rritje për të dhëna energjie. Eurostat organizon rregullisht grupet e punës për t'i dhënë përparësi nevojave të reja për të dhëna, në mënyrë që statistikat zyrtare të qëndrojnë relevante dhe të përafuara me nevojat e politikëbërësve dhe shoqërisë. Përfundimet e këtyre grupeve të punës mund të gjenden në raportet përmbledhëse të mëposhtme.

10. VLERËSIM I SHKURTËR I BURIMEVE TË RINOVUESHME TË ENERGJISË (SHARES)

Mjeti SHARES fokusohet në llogaritjen e harmonizuar të pjesës së energjisë nga burimet e rinovueshme. Përfitimi kryesor i mjetit SHARES është se vendet e BE-së angazhohen të ndjekin të njëjtën metodë për të llogaritur treguesit që lidhen me përqindjen e energjisë nga burimet e rinovueshme. Përdorimi i këtij mjeti parandalon parregullsitë që mund të lindin nga parametra dhe rregulla të ndryshme të përdorura në metoda të ndryshme llogaritjeje.

Mjeti SHARES fokusohet në llogaritjen e harmonizuar të pjesës së energjisë nga burimet e rinovueshme midis shteteve anëtare të BE-së. Baza ligjore për zbatimin e të gjitha llogaritjeve

dhe metodologjive bazohet në Direktivën 1 (BE) 2018/2001 (më pas referuar edhe si Direktiva e Energjisë së Rinovueshme ose RED II) dhe në Rregulloren 2 (KE) Nr. 1099/2008, për të cilën Direktiva referohet. Akronimi SHARES qëndron për Vlerësimin e Shkurtër të Burimeve të Energjisë së Rinovueshme. Mjeti SHARES është krijuar për të mbledhur dhe paraqitur informacionin - të dhënat e energjisë - që nevojiten për të monitoruar pjesën e energjisë nga burimet e rinovueshme sipas RED II. Ai nuk zëvendëson detyrimet e raportimit të përcaktuara në Rregulloren (BE) 2001/1999 mbi menaxhimin e bashkimit të energjisë dhe veprimin për klimën - ai vetëm ndihmon në raportim. Përfitimi kryesor nga përdorimi i mjetit SHARES është se Shtetet Anëtare kalojnë saktësisht të njëjtën metodë gjatë llogaritjes së pjesës së energjisë nga burimet e rinovueshme. Zbatimi i tij parandalon çdo parregullsi nga parametrat dhe rregullat e ndryshme të përdorura në metoda të ndryshme dhe siguron rezultate të harmonizuara dhe të krahasueshme për të gjitha vendet raportuese. Për këtë arsye, përdorimi i mjetit SHARES është më efikas sesa vlerësimet/llogaritjet individuale të kryera nga çdo Shtet Anëtar i BE-së.

Të dhënat janë të disponueshme në dosjen e bazës së të dhënave “Ndarja e energjisë nga burimet e rinovueshme”.

11. AKBN - AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në mbledhjen e të dhënave energjetike ka bashkëpunuar ngushtë me INSTAT-in, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Entin Regullator të Energjisë (ERE), Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Korporatën Energjetike Shqiptare (KESH), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) si dhe Kompanitë ARMO e Albpetrol.

Vlerësimi i të dhënave të bilancit është zhvilluar në konsultim me ekspertët e institucioneve të ndryshme të energjisë bazuar në të dhënat progresive në Sektorët e Energjisë Elektrike, Naftës dhe Gazit Natyror, Burimeve të Rinovueshme dhe Lëndëve të ngurta djegëse.

Analiza e Bilancit të Energjisë u krye duke përdorur modelin e EUROSTAT, një model bilanci i provuar dhe i përdorur më parë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe që përdoret nga të gjitha vendet e Evropës Juglindore. Rezultatet analitike ofruan matrica sasiore për vlerësimin e rezultateve të mundshme të Bilancit në shërbim të plotësisht të pyetsorëve analitik të energjisë.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) i raporton Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për zhvillimin, mbikëqyrjen e përdorimit racional të burimeve natyrore sipas politikës së qeverisë dhe monitorimin e post-shfrytëzimit të minieraleve, naftës dhe energjisë.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka një sërë përgjegjësish në fushën e energjisë të tilla si:

- propozimi, konsultimi dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin e politikave dhe strategjive në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- zbatimi i politikave qeveritare në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- hartimi dhe publikimi i bilancit vjetor të energjisë, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e Eurostat dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë;
- propozimi i masave për rritjen e përdorimit të energjisë në ciklin e energjisë;

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore prej vitit 2011 ndërton Bilancin Kombëtar të Energjisë në bashkëpunim me:

- EUROSTAT (Institucioni i Statistikave të Bashkimit Evropian), European Commission – Eurostat, Unit E.5: Energy, 2920 Luxembourg.
- IEA (Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë), (31-35, rue de la Fédération, 75739, Paris, Cedex 15, France).
- UNSD, (Institucionin e Statistikave të Kombeve të Bashkuara), United Nations Statistics Division, Energy Statistics Section 2 UN plaza, DC2-1414, New York, NY 10017, USA.

AKBN bashkëpunon me INSTAT duke i përgatitur të gjitha të dhënat në fushën e energjisë dhe të dy institucionet së bashku, këtë informacion e raportojnë në EUROSTAT duke ndjekur procedurat e EDAMIS (Sistemi Elektronik i Administrimit të të Dhënave dhe Menaxhimit të Informacionit <https://webgate.ec.europa.eu/edamis/>).

AKBN është pjesë e grupit të punës në “ENERGY COMMUNITY” (Komunitetin e Energjisë në Vjenë) për raportimin e statistikave të energjisë për Shqipërinë duke marrë pjesë regullisht në takimet që organizon ky institucion për statistikën e vendeve të Evropës Juglindore dhe të ish vendeve të Bashkimit Sovjetik.

AKBN-ja që prej vitit 2015 është pjesë e organizatës JODI (Iniciativa e Përbashkët e Organizimit të të Dhënave www.jodidata.org) institucion që bashkëpunon ngushtë me 6 organizata (APEC, Eurostat, IEA, OLADE, OPEC and UNSD) ku ne dërgojmë regullisht të dhënat mujore të prodhimit të naftës, gazit dhe të bilancit të rafinerive të Shqipërisë.

AKBN-ja, në bashkëpunim me EUROSTAT dhe IEA ndërton bilancin kombëtar të energjisë duke përmblodhur të dhënat në 5 pyetësorë (të naftës, gazit, qymyrit, energjisë elektrike dhe burimeve të rinovueshme). Përgatitja e këtyre pyetësorëve ka për qëllim të thjeshtësojë paraqitjen e të dhënave si dhe për të minimizuar riskun e të dhënave të gabuara.

AKBN-ja hedh të dhënat në programin SHARES (SHort Assessment of Renewable Energy Sources) i cili ka si qëllim të thjeshtësojë llogaritjen kontributit të Burimeve të Rinovueshme bazuar në direktivën 2009/28/EC. Kjo metodikë është e unifikuar për të gjitha vendet e BE-së dhe të Evropës Jug-Lindore. Zbatimi i saj parandalon çdo parregullsi të parametrave dhe rregulla të ndryshme të përdorura në metoda të ndryshme llogaritëse si dhe siguron rezultate të

harmonizuara dhe të krahasueshme për të gjitha vendet raportuese. Për këtë arsye, metoda SHARES konsiderohet të jetë një qasje më efikase në vlerësimet/llogaritjet individuale të kryera nga çdo shtet anëtar i BE.

12. BILANCI ENERGETIK 2023

Statistikat mbi energjinë prodhohen bazuar në të dhënat e grumbulluara nga burimet administrative, (mujore dhe vjetore) mbi sasinë e energjisë elektrike, gazit dhe naftës etj. Në bazë të këtyre statistikave hartohen Bilanci i Përgjithshëm i Energjisë. Burim kryesor për hartimin e bilanceve është Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Bilanci vjetor i përgjithshëm i energjisë

Bilanci energjistik është një dokument që paraqet situatën aktuale në sektorin e energjisë në Republikën e Shqipërisë. Ai paraqet origjinën dhe përdorimin specifik sipas burimeve të energjisë dhe përbëhet nga dy pjesë kryesore:

Furnizimi është llogaritur si fluks energjistik për atë kohë në të cilën prodhimi gjithsej i furnizuar i korrespondon "konsumit të dukshëm". Raporti i prodhimit kombëtar të energjisë me sasinë e energjisë së harxhuar, jep shkallën e pavarësisë energjitike në nivel kombëtar dhe për secilin burim energjie.

Përdorimi i energjisë është llogaritur pas përdorimit për konsum të "ndërmjetëm" (pas transformimit) ose për përdorim "final".

Bilancet e përgjithshme vjetore të energjisë për vendin paraqiten në njësi energjie kilo ton naftë ekuivalent (ktoe) dhe sigurohet si burim informacioni shërben Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

Përkufizime

Konsumi i brendshëm bruto është i barabartë me: $\text{Prodhim} + \text{Import} - \text{Eksport} \pm \text{Ndryshim stoku}$

Matja e stokut mbulon gjendjen e prodhuesve të energjisë, importuesve, shpërndarësve, transformuesve dhe përdoruesve finalë, kur ato njihen.

Konsumi final i energjisë i korrespondon energjisë së shpërndarë përdoruesve finalë, sipas origjinës dhe të gjitha llojeve të energjive pa kufizim.

Konsumi final jo energjistik llogarit përdorimet e energjisë si material primar, për përdorime joenergjitike.

Energjia parësore është energjia bruto, pas nxjerrjes, pa përfshirë asnjë transformim (linjit, naftë brut, gaz natyror, energji hidrike ose nukleare, etj.)

Energjia dytësore është energjia e fituar nga transformimi i një energjie parësore ose ndonjë energjie tjetër dytësore (në veçanti nga energjia elektrike me origjinë termike).

Bilancit energjetik për vitin 2023 prezanton problemet dhe sfidat e mprehta energjetike me të cilat ballafaqohet vendi ynë. Ende në informacinet që ndihmojnë në përgatitjen e bilancit energjetik ka probleme në sigurimin e të dhënave, sidomos nga sektori privat të cilat sigurohen me mjaft vështirësi. Këto problematika duhet të gjejnë zgjidhje nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor, i cili duhet të detyrojë institucionet publike dhe private të raportojnë bilancet energjetike duke përfshirë këtu dhe aktivitetet industriale. Në bashkitë e vendit tonë vazhdon akoma të këtë probleme në ndërtimin e një data-base për grumbullimin e të gjithë informacionit në territorin ku ato ushtrajnë aktivitetin.


Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në mbledhjen e të dhënave energjetike ka bashkëpunuar ngushtë me INSTAT-in, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Entin Regullator të Energjisë (ERE), Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Korporata Energjetike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) si dhe Kompania ARMO.

13. PRODUKTET PRIMARE

Furnizimi me energji primare në Shqipëri dominohet nga nafta, prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet si dhe biomasa, të cilat janë të pa mjaftueshme për realizimin e kërkesës totale për energji. Diferenca plotësohet nëpërmjet importit, veçanërisht për nënproduktet e naftës dhe energjisë elektrike si dhe qymyrit.


13.1 Nafta dhe Gazi

Prodhimi në vend i naftës për vitin 2023 ka patur një prodhim 642.04 ktoe me një ulje krahasuar me vitin 2022 prej 15.36 ktoe ose 2% si pasojë e problematikave së tregjeve të shitjes. Në vitin 2023 nafta brut nga marreveshjet hidrokarbure ishte 572.243 ktoe, ku shitjet brenda vendit kanë qenë 150.353 ktoe dhe eksportet 515.792 ktoe.




Grafiku 3. Ecuria e Prodhimit, Importit dhe eksportit të produkteve të naftës (ktoe)

Për vitin 2023 sasia e naftës brut për rafinim ka qenë 172.40 ktoe duke patur një ritje krahasuar me vitin 2022 prej 55.77 ktoe. Kjo ritje e sasisë së rafinimit ka ardhur si rezultat i ritjes së kërkesës të produkteve të naftës nga tregu i huaj.



Grafiku 4. Ecuria e përpunimit të naftës brut, (ktoe)


Importi i produkteve të naftës për vitin 2023 arrin vlerën 1181.679 ktoe me një ulje prej 24 ktoe krahasuar me vitin 2022. Produktet si gazoi, benzina, nafta e avioneve dhe gazi i lëngshëm i naftës vazhdojnë të dominojnë në importin e produkteve të naftës.



Grafiku 5. Ecuria e Import, Eksportit të produkteve të naftës, (ktoe)

Eksporti i naftës dhe i nënprodukteve të saj për vitin 2023 për naftën brut ishte 592.92 ktoe dhe krahasuar me vitin 2022 kemi një ritje prej 7.63 ktoe si pasojë e kërkesës nga tregu për bitum.

Prodhimi i gazit në vendin tonë për vitin 2023 ka qenë në total gaz shoqërues i naftës, rreth 48.49 milion Nm³, sasi gati e papërfillshme dhe që shërben vetëm për proceset teknologjike të industrisë së naftës. Është e kuptueshme se lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e situatës energjetike në vend, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në raportet e përdorimit të energjive ku deri më sot ngarkesa kryesore i takon nënprodukteve të naftës dhe energjisë elektrike.



Grafiku 6. Prodhimi i Gazit (ktoe)


Projekti TAP (Trans Adriatic Pipeline)

Deri në fund të vitit 2023, TAP-i ka finalizuar konceptet për zbatimin e produktit Brenda Ditës në TAP, pas bashkërendimit me Autoritetet Rregullatore, si një mjet fleksibiliteti ofruar për transportuesit dhe OST-të fqinje në Greqi, Itali dhe Bullgari. Në T1 të 2024-ës, TAP-i planifikon të zhvillojë një Konsultim Publik dhe t'ia nënshtrojë produktin e ri Brenda Ditës reagimeve nga tregu. Në Raportin Operacional Vjetor për vitin 2024, TAP-i do ta informojë ERE-n për statusin e zbatimit të produktit të ri. Kështu, deri në fund të vitit 2023, TAP-i ka transportuar gjithsej 29.37 bcma nga kufiri grekoturk në Kipoi, ku 25.9 bcma janë transportuar deri në Itali duke kaluar përmes Shqipërisë dhe afërsisht 2.87 bcma që kanë dalë drejt Greqisë dhe 1.73 bcma drejt Bullgarisë, sikurse tregohet më poshtë:

Nga COD (15/11/20) deri më 31 dhjetor 2023	Gjithsej KWh	Gjithsej Nm3	Gjithsej BCMA
Pika hyrëse e TAP (Kipoi)	344,746,893,269	29,372,582,610	29.37
Pika dalje e TAP (Nea Mesimvria - Greqi)	33,651,439,365	2,868,977,401	2.87
Pika dalje e TAP (Komotini – IGB)	20,294,983,310	1,730,946,066	1.73
Pika dalje e TAP (Melendugno-Itali) duke kaluar transit përmes Shqipërisë	287,673,713,593	24,540,814,317	25.90

13.2 Qymyri

Për vitin 2023 prodhimi i zhavorit bituminoz ka qenë 161.18 ktoe me nje rritje ne krahasim me vitin 2022 prej 12.3 ktoe si pasojë e përdorimit nga industria e çimentos. Prodhimi i qymyrit te vendit eshte exportuar, ndërsa importi i qymyrit është në vlerën 85.44 ktoe dhe ka nje ritje 26.76 ktoe.



Grafiku 7. Ecuria e Prodhimit dhe Importit të Qymyrit (kton)

14. PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëritë publike dhe private të licencuara për këtë aktivitet. Shoqëritë publike janë KESH sh.a. dhe shoqëria HEC Lanabregas sh.a., me 100% të aksioneve shtetërore. Subjektet private të licencuara në këtë veprimtari janë:

Prodhuesit me Përparësi, Prodhuesit e Pavarur dhe Vetë prodhuesit e Energjisë Elektrike, që zhvillojnë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike bazuar në Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar si dhe Ligjin nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili në Prill të vitit 2023 është zëvendësuar me Ligjin e ri nr. 24/2023 Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme. KESH sh. a vijon të jetë shoqëria më e madhe prodhuese e energjisë elektrike në Shqipëri. Përgjate vitit 2023 ka ushtruar aktivitetin e detyrimit të shërbimit publik bazuar në VKM-në nr. 456, datë 29.6.2022, ndryshuar “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

Për periudhën që mbulon ky vendim parashikohet që KESH sh.a. për menaxhimin e kaskadës dhe sigurimit të energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve në treg të rregulluar kryen procedurat sipas këtij vendimi, për depozitimin dhe shkëmbimin e tepricave të energjisë elektrike, vetëm pasi ka plotësuar nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal. Bazuar në këtë vendim, teprica e energjisë së prodhuesit publik është sasia e energjisë që mbetet pas furnizimit të plotë të nevojave të Furnizuesit Universal të Energjisë dhe të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Gjithashtu, shoqëria e prodhimit publik të energjisë ka të drejtë të bëjë optimizim financiar të kaskadës, vetëm në rastet kur nuk cënon sasi të nevojshme të furnizimit

të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe vetëm brenda periudhave javore ose mujore. Prodhuesit me përparësi dhe prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike janë subjekte të licencuara në vite nga ERE që shfrytëzojnë centralet ekzistuese apo të reja, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të privatizimit, marrëveshjeve të koncesionit apo kontratave për shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve prodhuese të energjisë elektrike.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri më 31 Dhjetor 2023 është rreth **2,675 MW**. Ky kapacitet ka pasur një nivel rritje në vitin 2023 prej rreth **26 MW**. Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i kompanisë publike KESH sh.a. është 1453 MW dhe përbën rreth 54.2 % të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë. Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të tjerë të energjisë elektrike është 1 222 MW dhe përbën rreth 45.8 % të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë.

Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2023

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2023 është **8,795,637 MWh**, nga i cili:

- **5,131,482 MWh** u prodhuan nga centralet në zotërim të kompanisë publike KESH sh.a.
- **3,664,155 MWh** u prodhuan nga centralet e tjera.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2023, nga KESH sh.a. zë **58.3 %** të gjithë prodhimin të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth **41.7 %**. Centralet e prodhimin të energjisë elektrike janë të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike ashtu dhe në rrjetin e shpërndarjes. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2023 është rreth 2,288 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 7,709 127 MWh.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2023 është rreth 382 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 1,086,510 MWh.

	TË DHËNA MBI PRODHUESIT 2023	Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2023 (MWh)
Prodhues publik	Prodhues Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)	Lidhur në OST	1	4	1,448	5,131,482
Prodhues te pavarur	Prodhues të Pavarur Hidro (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	4	9	438	1,204,762
Prodhues te pavarur	Prodhues të Pavarur Fotovoltaik (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OSSH	3	4	14	18,885
Prodhues me perparësi	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	33	51	402	1,372,883
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	137	178	334	1,005,636
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	17	17	34	61,989
			195	263	2670	8,795,637

Tabela 1. Të dhëna mbi prodhuesit e energjisë elektrike


Në figurën më sipër paraqiten të dhëna mbi prodhimin e energjisë elektrike për gjithë kategoritë e prodhuesve të cilët janë në operim. Në të njëjtën kohë në figurën më poshtë paraqitet prodhimi neto vendas për vitin 2023, duke evidentuar kontributin në prodhimin e energjisë elektrike të

KESH sh.a., si prodhues publik si dhe kontributet e prodhuesve të tjerë. Prodhimi i realizuar nga kompania publike KESH sh.a., ka vijuar të zero peshën kryesore në prodhimin vendas edhe përgjatë vitit 2023.

PRODHIMI NETO VENDAS 2023 (MWh)	2023
HEC-et / PPE ne rrjetin e OSSH sha	982,392
HEC-et / PPE ne rrjetin e OST sha	1,085,256
HEC-et e pavarur IPP ne rrjetin e OST sha	1,204,759
HEC Lanabregas	23,244
HEC Ashta	287,628
Centralet Fotovoltaike (Kontrat FTL)	61,989
Centralet Fotovoltaike (Ne treg te lire)	18,885
Prodhimi nga HEC-et e KESH sha	5,131,482
TOTAL VENDAS 2023	8,795,635

Tabela 2. Prodhimi neto i energjisë elektrike në vendin tonë

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2023 me sasinë e prodhuar prej 8,796 GWh, rezulton mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023. Mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023 ka rezultuar 6,770 GWh. Prodhimi i realizuar për vitin 2023 është rreth 2,026 GWh, ose 30 % më i lartë se mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023. Duke marrë në konsideratë konsumin total të energjisë elektrike në sasinë 7,876 GWh, prodhimi total i realizuar gjatë vitit 2023, rezulton me i larte se kerkesa per energji elektrike ne vendin tone, për rrjedhojë janë realizuar eksporte të energjisë elektrike.



Grafiku 8. Prodhimi neto vendas në raport me mesataren e prodhimit për periudhën 2009-2023

Prodhimi maksimal mujor i energjisë elektrike për vitin 2023 është shënuar në muajin Janar 2023 në sasinë **1,099,609 MWh**. Ky prodhim është realizuar nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. në masën deri **60.5 %**, ndërkohë që prodhimi minimal mujor i energjisë elektrike gjatë vitit 2023 rezulton në muajin Tetor në sasinë **398,348 MWh**. Në grafik evidentohet se viti 2023 konsiderohet si një vit i mirë hidrologjik nga pikëpamja e prodhimit të energjisë elektrike, i cili për këtë vit ka rezultuar në sasinë **8,796 GWh**, pra **2.026 GWh** më shumë se prodhimi mesatar i energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2023. Duke marrë në konsideratë faktin se vendi ynë e bazon prodhimin e energjisë elektrike kryesisht në burimet hidrike, në vitet e mira hidrologjike ku bën pjesë edhe viti 2023, prodhimi i energjisë elektrike është më i lartë se mesatarja shumë vjeçare në periudhën 2009 – 2023. Prodhimi i realizuar nga centralet hidrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2023 është në sasinë 1,005,636 MWh, ndërsa prodhimi i realizuar nga impiantet fotovoltaike është në sasinë 80,874 MWh.

14.1 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike

Shoqëria publike KESH sh.a. ka në zotërim tre hidrocentralet e kaskadës së Lumit Drin, termocentralin e Vlorës, si dhe impiantin fotovoltaik Qyrsaq me fuqi 5.14 MW. Përbërja e grupit të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a. dhe kapaciteti i instaluar i secilit prej tyre është

paraqitur në të dhënat më poshtë ku evidentohet numri i agregateve, kapaciteti i instaluar për çdo agregat dhe fuqia e instaluar për çdo central.

	HEC Fierze	Hec Koman	HEC V.Dejes	TEC Vlore	FV Qyrsaqe
Numri i Agregateve	4	4	5	2	
Kapaciteti i Instaluar i Agregateve (MW)	125	150	50	70+28	
Kapaciteti i Instaluar i Centralit Prodhues te en.el (MW)	500	600	250	98	5
Kapaciteti i instaluar ne Total	1453				

Tabela 3. Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.)

Kapaciteti total i instaluar në zotërim nga KESH sh.a., arrin në 1,453 MW, nga të cilat kapaciteti i instaluar i HEC-ve në kaskadën e lumit Drin është 1,350 MW, TEC Vlorë 98 MW si dhe ai i impantit fotovoltaik Qyrsaq 5.14 MWp. Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga centralet prodhuese të pavarur dhe ato me përparësi për vitin 2023 është 3,664,155 MWh ose rreth 41.7 % e prodhimit total vendas.

Për vitin 2023, numri i centraleve prodhuese të pavarur dhe ato me përparësi të cilat kanë prodhuar energji elektrike është 259 ku 13 prej të cilëve janë prodhues të pavarur të cilët zotërohen nga 7 subjekte të licencuara, kurse pjesa tjetër prej 246 centrale janë prodhues me përparësi të energjisë elektrike të cilët zotërohen nga 187 subjekte te cilet ushtrojne aktivitetin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Në këtë listë është përfshirë edhe HEC Lanabregas me kapacitet të instaluar 5 MW dhe prodhim vjetor për vitin 2023 prej 23,244 MWh, aksionet e të cilit sikurse sipërcituar janë 100% shtetërore. Në total, kapaciteti i instaluar i centraleve prodhuese të pavarur dhe prodhuesve me përparësi është 1,222 MW, ku kapaciteti i instaluar i centraleve të prodhuesve të pavarur është 452 MW, kurse 770 MW i përket centraleve të prodhuesve më përparësi të energjisë elektrike përfshirë dhe HEC-in Lanabregas. Fuqia e instaluar e centraleve të lidhur në sistemin e transmetimit për vitin 2023 është 2,288 MW. Prodhimi total i energjisë elektrike nga këto centrale është 7,709,127 MWh.

14.2 Gjendja e TEC-it Vlorë.

Shoqëria KESH sh.a. është aksionere e vetme e shoqërisë Termocentrali Vlorë sh.a. (TEC Vlorë sh.a.), shoqëri kjo e cila ka në administrim asetin gjenerues TEC Vlorë. Shoqëria TEC Vlorë sh.a. edhe përgjatë vitit 2023, ka kryer aktivitetin e saj në lidhje me konservimin e asetit gjenerues i cili nuk është në gjendje pune për shkak të problematikave të shfaqura që nga viti 2012.

14.3 Prodhimi nga impiantet fotovoltaike


Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes është 382 MW. Kapaciteti i instaluar i centraleve në rrjetin e shpërndarjes përbëhet nga 334 MW fuqi e instaluar në burime Hidrike dhe 48 MW fuqi e instaluar në impiante fotovoltaike. Prodhimi i realizuar nga centralet hidrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2023 është në sasinë 1,005,636 MWh, ndërsa prodhimi i realizuar nga impiantet fotovoltaike është në sasinë 80,874 MWh.

PRODHIMI PER VITIN 2023 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TE LIDHUR NE RRRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)				
CENTRALI FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2023
Seman 2	2	"SEMAN2SUN"sh.p.k	35 (kW)	3,748
Topoje	2	"SONNE" sh.p.k	35 (kW)	3,733
Topoje 2	2	"AED SOLAR" sh.p.k	35 (kW)	3,726
Topoje (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 (kW)	3,726
Topoje (Sheq Marinas) 2	2	"SEMANI SUNPOWER" sh.p.k	35 (kW)	3,799
Seman 1 Solar	2	"SEMANI SOLAR" sh.p.k	35 (kW)	3,751
ES 2019 sh.p.k	2	ES20199 sh.p.k	35 (kW)	4,179
FV SMART WATT	2	SMART WATT sh.p.k	35 (kW)	4,188
Tren Bilisht	2	"RTS" sh.p.k	35 (kW)	3,640
STATKRAFT Renewables albani PV lundrues Banje	2	"STATKRAFT"	35 (kW)	1,959
Plug Lushnje	2	AEE sh.p.k	10 (kW)	4,290
Korca Photovoltaic Park sh.p.k	2	Korca Photovoltaic Park sh.p.k	35 (kW)	3,691
NTSP sh.p.k/920	2	NTSP sh.p.k	35 (kW)	3,650
Sun Beat System sh.p.k/921	2	Sun Beat System sh.p.k	35 (kW)	3,691
Tren Sun System sh.p.k/919	2	Tren Sun System	35 (kW)	3,696
ERENI SOLAR	2	ERENI SOLAR	35 (kW)	3,080
GREEN ENERGY BILISHT	2	GREEN ENERGY BILISHT	35 (kW)	3,442
EZ - 5 Solar Park	10	EZ - 5 Solar Park	35 (kW)	9,051
EZ - 5 Solar Park		EZ - 5 Solar Park	35 (kW)	8,953
FV ALBSOLAR	2	"ALBSOLAR"sh.p.k		660
FV SUN ENERGY SOLUTION	2	SUN ENERGY SOLUTION sh.p.k		222
	48			80,875

Tabela 4. Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet Fotovoltaike

14.4 Konsumi i energjisë elektrike

Konsumi total vjetor i energjisë elektrike në vendin tonë (duke përfshirë edhe konsumin e klientëve në treg të parregulluar), për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2023, paraqitet në mënyrë grafike si më poshtë:



Grafiku 9. Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike ndër vite.


Siç vërehet në paraqitjen grafike, konsumi më i ulët i energjisë elektrike i regjistruar në vendin tonë është në vitin 2007, me 5,767,652 MWh, ndërsa konsumi më i lartë i energjisë elektrike është ai i regjistruar në vitin 2021, me 8,414,836 MWh, ku ky i fundit përbën dhe konsumin më të lartë historik në vendin tonë. Konsumi total i realizuar për vitin 2023 rezultoi 7,875,861 MWh, në pothuaj në të njëjtat vlera sa konsumi i arritur përgjatë vitit 2022. Konsumi i energjisë elektrike për vitin 2023 krahasuar me konsumin e vitit 2021 i cili është dhe konsumi maksimal i arritur rezultoi me një ulje prej 538,975 MWh. Ulja e konsumit të energjisë elektrike total në vend për vitin 2023, krahasuar me konsumin maksimal për vitin 2021, shkon në rreth 6.4 %. Në të njëjtën kohë, konsumi i energjisë elektrike total i realizuar për vitin 2023 është rreth 9.2 % më i lartë se konsumi mesatar vjetor i treguar në tabelë. Kjo ulje e konsumit total të energjisë elektrike është reflektuar për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, por veçanërisht për konsumatorët që furnizohen në tregun e parregulluar, të cilët për vitin 2021 kanë konsumuar rreth 1,361 GWh energji elektrike, për vitin 2022 këta konsumatorë kanë konsumuar rreth 929 GWh energji elektrike dhe për vitin 2023 rreth 858 GWh. Kjo ulje e konsumit ka ardhur edhe si pasojë e krizës energjitike në të cilën shumë biznese instaluan impiante alternative të gjenerimit të energjisë elektrike si vetë – prodhues. Konsumi i energjisë elektrike totale në vend përgjatë vitit 2023 është mbuluar nga gjenerimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a., prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike, prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, si dhe nga importi i energjisë elektrike.

14.5 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike

Në tabelën e mëposhtme paraqiten peshat specifike në faturim që zënë kategoritë e klienteve tarifore.


TE DHENA MBI SHPERNDARJEN E KONSUMATOREVE SIPAS RAJONEVE DHE KATEGORIVE												
Shperndarja mujore e Konsumatoreve	Berat	Burrel	Durres	Elbasan	Fier	Gjrokast	Korce	Kukes	Shkoder	Tirane	Vlore	Total
	106239	62402	180845	111932	85258	84181	94477	21996	120565	365400	100796	1334091
Familjare	90064	54853	159118	96934	73792	71959	38813	19151	104367	306472	13290	1028813
Private	14006	6180	19417	12974	9952	9958	9081	2268	14281	55204	13367	166688
Buxhetore	1007	690	871	948	646	1259	45048	319	954	1426	63401	116569
Jo- Buxhetore	320	304	287	401	248	293	262	87	276	440	51	2969
Konsum Vetiak	10	9	11	7	4	5	628	5	12	25	10136	10852
FMF	832	366	1141	668	616	707	645	166	675	1833	551	8200

Tabela 5. Shpërndarja e klienteve të OSHEE sipas rajoneve dhe kategorive gjatë vitit 2023



Grafiku 10. Shpërndarja e numrit të klienteve në vitin 2023 sipas kategorive në %

Të dhënat e paraqitura më sipër për vitin 2023 tregojnë se numri i përgjithshëm i klientëve për vitin 2023 është 1,334,091 dhe pjesën më të madhe të klientëve të FSHU sh.a. për këtë vit e zënë klientët familjarë, që përbëjnë 77.1 % të numrit total të klientëve të FSHU sh.a. Në shpërndarjen demografike të klientëve të FSHU sh.a. edhe për vitin 2023 pjesa më e madhe është në Tiranë, me rreth 27.4 % të të gjithë klientëve që ka FSHU sh.a. Struktura e klientëve të FSHU sh.a. reflektohet dhe në strukturën e faturimit të energjisë elektrike të realizuar për vitin 2023. Klientët familjarë zënë pjesën më të madhe në FSHU sh.a. dhe pjesën më të madhe të energjisë së faturuar për vitin 2023, ose 44.5 % të të gjithë faturimit të realizuar për vitin 2023. (81 423 531)




Grafiku 11. Klientët familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite

Konsumi i klientëve familjarë zë rreth 39.5% të konsumit total, shifër kjo më e lartë krahasuar me konsumin për të njëjtën kategori për vitin 2022, i cili ishte në masën 38.8%.

14.6 Import – Eksporti

Në grafikun e Figurës më poshtë është paraqitur balanca (hyrje – dalje) import-eksport e energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023. Për 10-vjeçarin e fundit, vendi ynë rezulton të jetë përgjithësisht një importues neto i energjisë elektrike me përjashtim të viteve 2010, 2016, 2018 dhe në 2021. Sqarojmë se vlerat e paraqitura përfaqësojnë të gjitha flukset hyrëse e dalëse nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.




Grafiku 12. Balanca Import – Eksport e energjisë elektrike në vite

14.7 Humbjet e energjisë elektrike

Gjatë vitit 2023, efektiviteti i shitjes së energjisë elektrike vazhdon në vlera të rritura, duke iu referuar gjithnjë faktorëve përcaktues në nivelin e eficiencës së konsumit të energjisë elektrike, të cilët janë:

- niveli i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje;
- niveli i arkëtimeve të energjisë elektrike së faturuar.

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga shoqëria për vitin 2023 arrijnë në **18.93%**, duke shënuar kështu ulje të nivelit të humbjeve krahasuar edhe me vitin 2022. Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga OSSH sh.a. është 99.4 % kundrejt energjisë elektrike të faturuar (shih tabelën e faturim – arkëtimeve më poshtë). Ky nivel arkëtimesh për vitin 2023 rezulton me rritje, krahasuar me nivelin e arkëtimeve të realizuara për vitin 2022. Këto vlera të arkëtimeve përfshijnë edhe arkëtimet e prapambetura, të cilat janë realizuar në vitin respektiv.



Grafiku 13. Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes

15. BURIMET E RINOVUESHME

Qeveria Shqiptare po vazhdon përpjekjet për një ekuilibër më të mirë midis diversifikimit të burimeve të prodhimit të energjisë, sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtjes së natyrës dhe sistemit të qëndrueshëm në mënyrë që të rrisë prodhimin vendas, të zvogëlojë nivelin e humbjeve teknike dhe jo teknike të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes si dhe duke zvogëluar sasinë e energjisë së importuar për të përmbushur kërkesën për energji elektrike në vend.

Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) 2020 - 2030, me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 872, datë 29.12.2021. Gjatë periudhës Janar - Prill 2022, drafti i PKEK-ut është rishikuar në bazë të rekomandimeve të EnC-së. Në dokumentin e rishikuar synohet të ulet konsumi final i energjisë me 9.4% krahasuar me 8.4% në versionin e mëparshëm, pesha e energjisë së rinovueshme në konsumin final të energjisë është rritur në 59.4% krahasuar me 54.4%, ndërsa emetimet e GS-ve mbeten në 18.7%.

Kapaciteti shtesë prodhues i propozuar, i planifikuar apo në fazë ndërtimi


Të dhënat e parashtruara më poshtë paraqesin centrale të energjisë elektrike të cilat janë lidhur në rrjetin e transmetimit në vitin 2023, janë në fazë ndërtimi, ose kanë marrë miratimin paraprak për lidhjen me rrjetin e transmetimit si më poshtë vijon:

2023	Kontrata Marreveshje me MIE - VKM 349, 12.06.2020	Kontrata sipas VKM 822/2015	TOTALI
Nr. Total i Kontratave	1	55	56
Ne Prodhim	1	20	21
Fuqja e Instaluar (MW)	140	48	188
Ne ndertim		11	11
Fuqja e Instaluar (MW)		202	202
Nuk kane filluar akoma		24	24
Fuqja e Instaluar (MW)		146	146


Tabela 6. Centrale që kanë lidhur marrëveshje deri në vitin 2023 dhe priten të energjizohen gjatë viteve 2022-2023

Energjia e Rinovueshme në Bilancin e Energjisë

Shqipëria vazhdoi me zbatimin e ankandeve për projektet e energjisë së rinovueshme dhe hartoi ndryshime në legjislacionin ekzistues për të dhënë qartësi në skemën e mbështetjes. Megjithëse sektori i energjisë elektrike është pothuajse tërësisht i rinovueshëm në Shqipëri, nevojiten përpjekje shtesë, në ngrohje dhe ftohje, si dhe në sektorin e transportit, për të arritur objektivin e përgjithshëm të burimeve të rinovueshme. Skemat mbështetëse jepen, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.06.2018 “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, si dhe procedurat e përzgjedhjes së projekteve për përfitimi i tyre”, për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, nëpërmjet një procesi konkurrues, të hapur, transparent dhe jodiskriminues, që u ofron kredibilitet pjesëmarrësve dhe garanton dhënien e këtyre masave subjekteve që ofrojnë më të mirën. kushtet për sa i përket çmimit të energjisë, teknologjisë së përdorur dhe mënyrës së ndërtimit të centralit.



Grafiku 14. Ecuria aktuale e kontributit të RES në Shqipëri



Grafiku 15. Ecuria e prodhimit të burimeve të rinovueshme (TJ)

16. DRUTË E ZJARRIT

Drutë e zjarrit janë një burim i rëndësishëm energjie, të cilët kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontribut të ndjeshëm në bilancin energjetik shqiptar, në plotësimin e nevojave për ngrohje, ujë të ngrohtë dhe gatim. Në vitin 2023, rezulton që 87% e druve të zjarrit janë konsumuar në sektorin e banesave dhe vetëm një pjesë e vogël në sektorin e shërbimeve dhe të industrisë. Krahasuar me periudhën e viteve të kaluara, vihet re që struktura e konsumit të druve të zjarrit sipas sektoreve ka ruajtur të njëjtin tipar, atë të përdorimit të tyre në sektorin e banesave.

Vlen të përmendim që gjatë vitit 2023 vendi ynë ka importuar dru zjarri për konsum energjie si dhe për prodhimin e peletave. Aktualisht në vendin tonë ka 6 fabrika që prodhojnë peletat të cilat kryesisht i eksportojnë dhe fare pak qëndrojnë tek konsumatorët tanë. Konsumi i druve të zjarrit edhe në vitin 2023 është 137 ktoe (i llogaritur) me një ulje, 7 ktoe krahasuar me vitin 2022.

17. HIDROENERGJIA

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2023 me sasinë e prodhuar prej 8,796 GWh, rezulton mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023. Mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023 ka rezultuar 6,770 GWh. Prodhimi i realizuar për vitin 2023 është rreth 2,026 GWh, ose 30 % më i lartë se mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023. Duke marrë në konsideratë konsumin total të energjisë elektrike në sasinë 7,876 GWh, prodhimi total

i realizuar gjatë vitit 2023, rezulton me i larte se kërkesa per energji elektrike ne vendin tone , për rrjedhojë janë realizuar eksporte të energjisë elektrike.

Prodhimi maksimal mujor i energjisë elektrike për vitin 2023 është shënuar në muajin Janar 2023 në sasinë **1,099,609** MWh. Ky prodhim është realizuar nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. në masën deri **60.5** %, ndërkohë që prodhimi minimal mujor i energjisë elektrike gjatë vitit 2023 rezulton në muajin Tetor në sasinë **398,348** MWh.

Në grafik evidentohet se viti 2023 konsiderohet si një vit i mirë hidrologjik nga pikëpamja e prodhimit të energjisë elektrike, i cili për këtë vit ka rezultuar në sasinë **8,796** GWh, pra **2.026** GWh më shumë se prodhimi mesatar i energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2023. Duke marrë në konsideratë faktin se vendi ynë e bazon prodhimin e energjisë elektrike kryesisht në burimet hidrike, në vitet e mira hidrologjike ku bën pjesë edhe viti 2023, prodhimi i energjisë elektrike është më i lartë se mesatarja shumë vjeçare në periudhën 2009 – 2023.

18. BOKARBURANTET

Biokarburantet të mbështetura në ligjin nr. 9876/2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregëtimin e bio-karburanteve dhe të lëndëve të para djegëse, të rinovueshme, për transport” vazhdojnë të risin kontributin e tyre në konsumin final të energjisë për vitin 2023. Sasia e përzier me biodiezel ka qenë 159 ktoe.

19. ENERGJIA DIELLORE

Në Shqipëri rrezatimi diellor vjetor është i lartë dhe teorikisht mund të sigurojnë një ngrohje të nevojshme me temperaturë të ulët gjatë gjysmës së vitit. Gjithsesi panelet diellore të disponueshëm në tregjet shqiptare pjesërisht ndihmohen nga energjia elektrike, vecanërisht gjatë periudhës nëntor-mars. Në këtë kuadër Shqipëria ka bërë gjithashtu progres të dukshëm ku sipas vlerësimeve sipërfaqja kumulative e sistemeve të prodhimit të ujit të ngrohtë nga rrezatimi diellor është 24,5m²/1000 banorë. Për vitin 2023 energjia diellore e konsumuar për ujë të ngrohtë është 14.14 ktoe.

Gjatë vitit 2023 kanë hyrë në prodhim subjektet e mëposhtme, të cilat realizojnë prodhim të energjisë elektrike nga centrale fotovoltaike.

PRODHIMI PER VITIN 2023 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TE LIDHUR NE RRRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)				
CENTRALI FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2023
Seman 2	2	"SEMAN2SUN"sh.p.k	35 (kW)	3,748
Topoje	2	"SONNE" sh.p.k	35 (kW)	3,733
Topoje 2	2	"AED SOLAR" sh.p.k	35 (kW)	3,726
Topoje (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 (kW)	3,726
Topoje (Sheq Marinas) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 (kW)	3,799
Seman 1 Solar	2	"SEMANI SOLAR" sh.p.k	35 (kW)	3,751
ES 2019 sh.p.k	2	ES20199 sh.p.k	35 (kW)	4,179
FV SMART WATT	2	SMART WATT sh.p.k	35 (kW)	4,188
Tren Bilisht	2	"RTS" sh.p.k	35 (kW)	3,640
STATKRAFT Renewables albani PV lundrues Banje	2	"STATKRAFT"	35 (kW)	1,959
Plug Lushnje	2	AEE sh.p.k	10 (kW)	4,290
Korca Photovoltaic Park sh.p.k	2	Korca Photovoltaic Park sh.p.k	35 (kW)	3,691
NTSP sh.p.k/920	2	NTSP sh.p.k	35 (kW)	3,650
Sun Beat System sh.p.k/921	2	Sun Beat System sh.p.k	35 (kW)	3,691
Tren Sun System sh.p.k/919	2	Tren Sun System	35 (kW)	3,696
ERENI SOLAR	2	ERENI SOLAR	35 (kW)	3,080
GREEN ENERGY BILISHT	2	GREEN ENERGY BILISHT	35 (kW)	3,442
EZ - 5 Solar Park	10	EZ - 5 Solar Park	35 (kW)	9,051
EZ - 5 Solar Park		EZ - 5 Solar Park	35 (kW)	8,953
FV ALBSOLAR	2	"ALBSOLAR"sh.p.k		660
FV SUN ENERGY SOLUTION	2	SUN ENERGY SOLUTION sh.p.k		222
	48			80,875

Tabela 7. Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet Fotovoltaikë

20. ENERGJIA E ERËS

Shqipëria ka potencial për energji të erës, por teknologjia nuk është zhvilluar. Megjithatë, ka plane për zhvillimin e projekteve për shfrytëzimin e erës në vitet e ardhshme. Potenciali i energjisë së erës në vendin tonë është rreth 2000 MW. Era gjeneron fuqi mekanike nëpërmjet turbinave të erës. Ultesirat bregdetare dhe Jugore, Lindore, si dhe malet në Veri të Shqipërisë janë zona të mira për turbinat e erës. Megjithatë, ekzistojnë edhe pengesat të cilat marrin pjesë në zgjedhjen e një lokacioni, duke përfshirë: lartësia, qasja e vendit, infrastruktura, zonat e mbrojtura, dhe rrjeti i energjisë. Shpejtësia e erës është 8–9 m/s në shumë zona të Shqipërisë.

21. TRANSFORMIMI

21.1 Energjia Hidrike

Për vitin 2023 prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet arriti një prodhim bruto në vlerën 9006.016 Gwh.


21.2 Rafineritë

Për vitin 2023 rafineritë kanë punuar në mënyrë periodike, duke përpunuar rreth 172.04 ktoe kryesisht dy rafineri Fieri dhe Elbasani, me një humbje teknologjike 0.6%. Sektori i rafinimit të naftës bruto vazhdon të përballet me vështirësi serioze, si pasojë e problemeve ekonomike të shoqërisë që administron këtë sektor. Vlen të theksojmë se rafineritë tona kanë probleme serioze në kontrollin e ndotjeve mjedisore, për shkak të mungesës së investimeve në këtë sektor pasi teknologjia e përdorur është e vjetër dhe e amortizuar.

22. KONSUMI I ENERGJISE SIPAS SEKTOREVE

22.1 Sektori i industrisë

Bilanci i energjisë, sektorin e industrisë e paraqet të ndarë në 10 nënsektorët: metalurgji, kimi, materiale ndërtimi, miniera, ushqim/pije/duhan, tekstil/lëkurë/këpucë, dru/letër/printim, mekanike dhe të tjera. Konsumi i energjisë në këta nënsektorë është përqëndruar në vënien në punë të pajisjeve motorike si dhe për procese teknologjike. Në vendin tonë konsumatorë të lartë të energjisë në këta nën sektorë janë industria e materialeve të ndërtimit si dhe industria metalurgjike.




Grafiku 16. Ecuria e konsumit sipas sektorëve të ekonomisë (ktoe)

Për vitin 2023 ecuria e konsumit në sektorin e industrisë ka pësuar një ritje prej 34.02 Ktoe


22.2 Sektori i transportit

Nga të dhënat e sektorit të transportit në Shqipëri shihen tendenca në rritje të aktiviteteve të tij, në drejtim të shpërndarjes së peshës në aktivitetet e tij që synon t'i përgjigjet sfidës globale për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Vlen të theksojmë që sektori i transportit në Shqipëri duhet të zbatojë masat të rrepta që përmirësojnë në mënyrë të konsiderueshme eficiencën e energjisë si dhe për t'i hapur rrugën uljes së emetimeve që vijnë nga ky sektor.



Grafiku 17. Ecuria e konsumit të produkteve të naftës sipas sektoreve, (ktoe)

Sektori i transporti në Shqipëri vazhdon ritmin e ritjes në masën 2.5-3% duke patur një peshë më të lartë në konsumin e lëndëve energjetike në masën 36.97%. Ndikim në këtë zhvillim ka përmirësimi i infrastrukturës rrugore e cila ka rritur numrin e automjeteve, duke rritur ngarkesën totale të trafikut nga viti në vit. Për vitin 2023 numri i automjeteve arriti 867765 nga 796,438 mjete që kishte viti 2022. Për vitin 2023 konsumi i këtij sektori në të gjitha aktivitetet e tij është **705.84** ktoe ndërsa në vitin 2022 ishte 712.40 ktoe, ku pjesën dominuese të konsumit vazhdon ta ketë transporti rrugor në kontrast me transportin hekurudhor dhe transportin ujor.



Grafiku 18. Ecuria e stokut të automjeteve

22.3 Sektori i banesave

Konsumi i energjisë në sektorin e banesave përfshin një mori shërbimesh energjetike përfshirë ngrohjen e hapësirave, kondicionimin e ajrit, ujin e ngrohtë, gatimin, ndriçimin dhe pajisjet elektroshtëpiake. Nga analiza e të dhënave të bilancit energjetik vazhdon konsumi drejt përdorimit të energjisë elektrike për ngrohjen e hapësirave krahasuar me lëndët e tjera energjetike si drutë e zjarrit dhe LPG.

Kërkesa për energji nga sektori i banesave përbën një sfidë të madhe për vendin tonë pasi ky sektor konsumon 51% të konsumit kombëtar të energjisë elektrike. Vlen të theksojmë se në zonat rurale vazhdon konsumi i drutë të zjarrit për ngrohje dhe gatim.

Sektori i banesave zë vendin e dytë në sasinë e konsumit final të energjisë në Shqipëri, pas transportit me një peshë specifike prej 26.16%. Për vitin 2023 në këtë sektor shihen tendenca për një konsum eficient të energjisë si pasojë e kontrollit të energjisë elektrike e cila ka peshën kryesore të lëndëve energjetike. Në këtë vit konsumi i energjisë në këtë sektor është 499.59 ktoe ndërsa për vitin 2022 ishte 515.73 ktoe, me një ulje prej 2.9 %

22.4 Sektori i shërbimeve

Sektori i shërbimeve ndahet në dy nënsektorë: shërbimet publike dhe shërbimet private. Ky sektor në vlerësimet tona është kategorizuar së bashku me sektorin publik dhe aktivitetin tregtar jo-industrial (që njihet gjithashtu si “sektori terciar”). Tradicionalisht, sektori i shërbimeve publike për të siguruar ngrohjen, mbështetet tek konsumi i energjisë elektrike dhe i drutë të zjarrit.

Në analizën e bilancit energjetik të vitit 2023 u vlerësuan 11.1 milionë m² sipërfaqe e përgjithëshme grupit të llojeve kryesore të ndërtesave publike, shifër që nuk pritet të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme.

Ashtu si në sektorin e banesave, përqindja e konsumit final të energjisë në sektorin e shërbimeve ka mbetur e qëndrueshme, duke zënë 11 % të të gjithë konsumit final të energjisë. Kjo është në kontrast me pritshmëritë e zhvillimit të këtij sektori, që parashikon një rritje më të shpejtë por është diktuar nga zhvillimi ekonomik i vendit tonë.

Në terma absolutë, konsumi i energjisë në këtë sektor për vitin 2023 ishte 206.25 ktoe ose 1.2% më i lartë se në vitin 2022.

22.5 Sektori i bujqësisë

Të dhënat nga INSTAT tregojnë se në fund të 2023, pesha e bujqësisë ndaj totalit të ekonomisë arriti në 19.3% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), nga 18.4% në dy vitet e mëparshme. Gjatë dekadës së fundit, pavarësisht një sërë problemesh strukturore, sektori ka patur një rritje të moderuar. Zgjerimi i sektorit, gjatë periudhës 2022-2023, mendohet të ketë kontribuar në performancën e përgjithshme të ekonomisë në vend. Përveç kësaj, rritja e çmimeve të produkteve bujqësore në tregjet botërore përcjell stimujt e duhur për rritjen afatgjatë të prodhimit të kësaj dege të ekonomisë shqiptare. Për më tepër, zhvillimet dhe reformat strukturore (që synojnë rritjen e efikasitetit në prodhimin bujqësor, lehtësimin e aksesit të produkteve bujqësore në tregun e brendshëm dhe tregjet e huaja, si dhe mbështetjen financiare të bizneseve dhe fermave të këtij sektori) janë konsideruar si një prioritet i politikave ekonomike të ardhshme.

Parë në aspektin e konsumit të energjisë sektori i bujqësisë ku futet edhe peshkimi në bilancin e konsumit të energjisë për vitin 2023 zë një peshë 5.43%. Parë në kontributin e këtij sektori në ekonominë shqiptare ky sektor vazhdon të ecë me ritme të ngadaltë në modernizimin e tij. Për vitin 2023 konsumi i këtij sektori ishte në vlerën 103.16 ktoe.

23. ANEKS BILANCI ENERGETIK 2023

	Year 2023	TOTAL	Solid fuels	Natural Gas	Crude, NGL and Feedstock	Biomass (Fuelwood)	Hydro & Electricity	Solar Energy	Derived Heat
	Primary production	1773.36	161.18	38.8	642.04	137	774.52	14.14	5.7
	Recovered products	0.00			0.0				
	Imports (Pet Prod+ Electricity)	1435.68	85.45		1181.68	3.28	165.27		
	Stock change	50.62			50.62				
	Exports	953.93	116.55		591.92	1.08	244.37		
	Bunkers	31.51			31.51				
	Gross inland consumption	2172.98	130.07	38.8	1149.66	139.20	695.41	14.14	5.70
	Transformation input	946.92			172.40		774.52		
	Classic thermal Power Stations	0.00			0		0		
	Public Hydro power stations	774.52					774.52		
	Autoprod. thermal power stations	0.00			0.00		0		
	Nuclear power stations	0.00							
	Patent fuel and briquetting plants	0.00							
	Coke-oven plants	0.00							
	Blast-furnace plants	0.00							
	Gas works	0.00							
	Refineries	172.40			172.40				
	District heating plants	0.00							
	Transformation output	853.96	0	0	168.40	0	684.55	0.00	1
	Classic thermal Power Stations	0.00					0.00		
	Public Hydro power stations	753.65					753.65		
	Autoprod. thermal power stations	0.00							
	Nuclear power stations	0.00							
	Patent fuel and briquetting plants	0.00							
	Coke-oven plants	0.00							
	Blast-furnace plants	0.00							
	Gas works	0.00							
	Refineries	169.40			168.40				1
	District heating plants	0.00	0						
	Exchanges and transfers, returns	0.00			4.00				
	Interproduct transfers	0.00							
	Products transferred	0.00							
	Returns from petrochem. industry	0.00							
	Transformation Losses	27.30	0	0	8.16	0	18.94	0.00	0.2
	Consumption of the energy branch	83.33	0	34.6	18.38	0	30.35	0	0
	Production and distribution of electricity	11.62					11.62		
	Pumped storage stations	0.00							
	District heating plants	0.00							
	Extraction and aggl. of solid fuels	6.63					6.63		
	Coke-oven and gas works plants	0.00							
	Oil and Nat. Gat extraction plants	46.73		34.6	4.30		7.83		
	Oil & Gas pipelines	0.00			0				
	Oil refineries	18.35		0.0	14.08		4.27		
	Nuclear fuel fabrication plants	0.00							
	Distribution losses (humbje jo tekn ne shpernd)	76.74	0	0	0	0	76.74		0.00
	Available for final consumption	1973.95	130.07	4.2	1123.12	139.20	558.52	14.14	4.70
	Final non-energy consumption	63.48		0.0	63.48				
	Chemical industry	1.97			1.97				
	Other sectors	61.50		0.0	61.50				
	Final energy consumption	1908.50	130.1	4.2	1057.7	139.20	558.52	14.14	4.7
	Industry	394.67	127.27	4.2	110.56	6.6	139.65	1.70	4.7
1	Iron & steel industry	31.51			2.80		28.71		
2	Chemical industry	15.20			8.92		6.28		
3	Non-ferrous metal industry	20.08	3.15		0.39		16.54		
4	Non-metallic minerals	190.23	124.12		52.23	2.44	11.44		
5	Transport equipment	5.75			0.00		5.75		
6	Machinery	0.00			0.00		0.00		
7	Mining and quarrying	28.38			10.19		18.20		
8	Food, drink & tobacco industry	53.03		4.2	17.48	4.16	20.80	1.70	4.7
9	Paper and printing	9.16			2.74		6.42		
10	Wood and wood products	1.01			0.00		1.01		
11	Construction	15.67			3.85		11.81		
12	Textile, leather & clothing industry	15.81			3.14		12.67		
13	Other industries	8.83			8.83		0.00		0.00
	Transport	706.00	0	0.00	705.47	0.00	0.53	0.00	0
	Railways	2.00			2.00				
	Road transport	611.03			610.50		0.53		
	Air transport	59.81			59.81				
	Inland navigation	33.16			33.16				
	Households, commerce, pub. auth., etc.	705.84	2.8	0.00	160.54	121.9	408.16	12.44	0.00
	Households	499.59	0		97.65	111.20	282.45	8.30	
	Agriculture	63.02			46.90	10.7	5.43		
	Fisheries	40.14			35.38		4.76		
	Other	0.00			0.00				
	Statistical difference				0.00			0	0

